



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-19401

Dt. 20.09.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Driton (Tefik) Prushi** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, me etazhitet P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97 bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesëve: Driton (Tefik) Prushi nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, sipas projektit ideor të prezentuar, në përputhshmëri me Planin Urbanistik “Vendbanimi Joformal – Brekoci”, në ngastrën kadastrale me nr. 313/20, Z.K. Brekoc, në rrugën “Gjon Buzuku”, në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+1, me sipërfaqe të përgjithëshme (bruto) të objektit **S= 250.14 m²**.

Përdhesa: (Sip,Bruto): **S= 123.65 m²**

Kati i parë: (Sip,Bruto): **S= 126.49 m²**

VËREJTJE:

- Meqenëse objekti është i kategorisë I-rë, sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH nr.06/2017 neni 8.5 nuk kërkohet Projekti kryesor, por i njëjti kërkohet të jetë në vend ndërtim para se të fillojë ndërtimi.
- Projekti i ndërtimit të realizuar dorëzohet për aplikim për Certifikatë të Përdorimit (neni 9.3)

II. Hartimin e projektit ideor me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese ndërtimore “Real – PROJECT” - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar që:

- Të të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Pa pëlqimin e hartuesit të projektit ideor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.



Arsyetim

Driton (Tefik) Prushi nga Gjakova, me banim në rrugën “Gjon Buzuku” ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-19401 të datës 05.09.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, me etazhitet P+1, në ngastrën kadastrale me nr. 313.20, Z.K. Brekoc, në rrugën “Gjon Buzuku”, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 12.07.2017, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 30.06.2017 (fotokopje) në pronësi të Driton (Tefik) Prushi nga Gjakova, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronë e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 3398/17, të datës 30.06.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Aktendimin – Lejen Ndërtimore, me nr. 05-351-736, dt. 14.06.1982, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm, punë komunale e strehimore, i Komunës së Gjakovës, së bashku me Kopjen e Planit të datës 11.06.1982, i vërtetuar nga ky organ.
5. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-a-609 të datës 30.06.20177.
6. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr.1431 të datës 10.08.2017.
7. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A.Gjakovë, nr. 2325 të datës 08.08.2017.
8. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 02.08.2017.
9. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Postën e Kosovës, filiala Gjakovë, me datë 12.09.2017.
10. Projektin ideor në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga ndërmarrja projektuese ndërtimore "Real – PROJECT" – Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 642.85 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktivendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspekcionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.


U. D. Drettori

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.



K.K. GJAKOVË
Zona kadastrale : BREKOC
Parcela nr.313-20

PLAN SITUACIONI



LOKACIONI : DRITON PRUSHI
S = 112 m²

Aprovohet ndërimi i lokacionit për objektin e banimit individual-shtëpi familjare nga 10.0mx11.0m (sipas Lejes së Ndërtimit me nr. 05 numër 351-736, dt.14.06.1982) në 11.2mx10.0m.

Gjendja kadastrale

Gjendja faktike

Gjakovë;
31.07.2017

Punoi:
Fatmir Bobi tek.

Vërteton urb.
Durrrije Berisha I.D.A.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GJAKOVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Brekoc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70705008-00313-20	Pracelë / Parcela / Parcel	441,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:500

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 30.06.2017

Koha/ Vreme/ Time: 02:07:27

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: MCO GJAKOVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

